



Marrëveshja mbi Llogarinë e Kursimeve për pako

Neni 1

Lënda e kësaj Marrëveshje është hapja dhe mirëmbajtja e llogarisë së Kursimeve me nr. [CURRENT.ACCOUNT]

Neni 2

Kjo Marrëveshje mbi Llogarinë e Kursimeve për pako lidhet me klientët të cilët kanë Marrëveshje mbi shfrytëzimin e pakos për llogari rrjedhëse valide dhe Banka i ofron dhe llogarit Klientit normën efektive të interesit (NEI) prej 0.01% në vit nga dita kur fondet janë deponuar në llogarinë e kursimeve dhe paguan interesin e fituar në baza mujore, në bazë të normës së interesit të paraparë në vendimin e Bankës dhe nga kjo shumë e interesit të fituar Banka do të mbaj tatimin në burim e cili do ti paguhet Administratës Tatimore. Interesi për mjetet e deponuara do të llogaritet në baza ditore duke e marrë numrin aktual të ditëve, vitin me 365 ditë ose 366 ditë për vitet e brishta dhe duke e shumëzuar me përqindjen e interesit. Norma efektive e interesit llogaritet në pajtim me Rregullën e BQK-ës. Nëse për çfarëdo arsyeje qoftë Marrëveshja mbi shfrytëzimin e pakos për llogari rrjedhëse ndërpritet ose shkëputet ose pushon së aplikuari ndërmjet palëve, atëherë me anë të kësaj Marrëveshje Klienti pajtohet që nga momenti i përfundimit të Marrëveshjes mbi shfrytëzimin e pakos për llogari rrjedhëse, për këtë Marrëveshje do të aplikohet norma më e ulët efektive të interesit që parashihet me tarifën e Bankës për klient të rregullt. Përqindja e interesit është e ndryshueshme dhe Banka rezervon të drejtën që në çdo kohë të ndryshoj normën e interesit, tarifat, provizionet ose kushtet e tjera të përfshira në këtë Marrëveshje dhe për këto ndryshime do ta njoftoj Klientin me shkrim nëpërmjet (SMS-ve, emailit, postës) 30 ditë më përpara pa pasur nevojë që të nënshkruhet ndonjë amandament për këtë Marrëveshje.

Banka do të llogarisë dhe të ndaloj shumën e caktuar për mirëmbajtjen e Llogarisë së Kursimeve dhe shërbimeve tjera që ofrohen sipas tarifave dhe provizioneve të Bankës.

Neni 3

Nëse gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje legjislacioni i aplikueshëm pëson ndryshime, të cilat e obligojnë Bankën që të aplikoj ndalesa, taksa ose tatime shtesë atëher palët kontraktuese pajtohen se Banka ka të drejtë të aplikoj ndalesa, taksa ose tatime shtesë konform ligjeve në fuqi. Banka ka të drejtë vonese, bllokimi ose refuzimi të pagesës nëse ekziston dyshimi se fondet e deponuara në llogarinë e kursimeve mund të jenë ilegale ose në kundërshtim me ligjet e aplikueshme në Kosovë. Banka rezervon të drejtën që ti përmirësoj gabimet që ndodhin gjatë procesimit të transaksioneve të pagesave pa ndonjë njoftim ose aprovim paraprak të Klientit. Në rast se në llogarinë e Klientit është transferuar ndonjë shumë pa arsye atëher Klienti obligohet që ta njoftoj Bankën dhe ta kthej shumën e transferuar.

Neni 4

- Klienti ka të drejtë të deponoj para të gatshme ose tërheqë mjete nga Llogaria e Kursimeve gjate orarit zyrtar të punës Bankës.-

Neni 5

Klienti është i obliguar që të ketë fonde të mjaftueshme për pagesën e tarifave të mirëmbajtjes së Llogarisë së Kursimeve dhe shërbimeve tjera. Banka gëzon të drejtën që pa paralajmërim të mbyll Llogarinë e Kursimeve nëse Klienti nuk i ka paguar shpenzimet e mirëmbajtjes së Llogarisë së Kursimeve dhe shërbimeve tjera. Banka rezervon të drejtën që në çdo kohë të ndryshoj tarifat, provizionet ose kushtet e tjera të përfshira në këtë Marrëveshje dhe për këto ndryshime do ta njoftoj Klientin me shkrim nëpërmjet (SMS-ve, emailit, postës) 30 ditë më përpara pa pasur nevojë që të nënshkruhet ndonjë amandament për këtë Marrëveshje. Të gjitha shkresat dhe njoftimet e dërguara nga Banka në numrin e telefonit ose email adresën e dhënë nga Klienti do të konsiderohen se janë pranuar nga Klienti ditën e ardhshme të punës nga dërgimi, shkresat dhe njoftimet e dërguara nga Banka me postë të rregullt në adresën e Klientit të cekur në këtë Marrëveshje do të konsiderohen se janë pranuar nga Klienti ditën e dytë të punës nga dorëzimi në postë pa pasur nevojë për ndonjë dëshmi ose deftesë shtesë. Kjo Marrëveshje mund të shkëputet nga secila palë brenda një periudhe prej 30 ditësh, pas ditës kur merret njoftimi me shkrim nga pala tjetër.



Neni 6

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje Klienti deklaron se është njoftuar nga Banka për të drejtën e tij/saj për posedimin e draftit të marrëveshjes pa pagesë, për të mundësuar shqyrtimin e kontratës para nënshkrimit të saj dhe në këtë mënyrë Klienti ka pas mundësi të zgjedhë ofertën me të leverdishme për të. Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje Klienti deklaron vullnetarisht ia ka vënë në dispozicion Bankës të dhënat e veta personale, dokumentet e identifikimit si dhe informacionet në lidhje me biznesin tij me Bankën dhe me anëtarët e Raiffeisen Banking Group dhe shprehimisht e jep pëlqimin që Banka dhe anëtarët e Raiffeisen Banking Group brenda dhe jashtë vendit t'i përdorin, ti përpunojnë dhe ti ruajnë këto të dhëna për identifikimin tij të qartë, për mbrojtjen e interesave të tija pronësore në raportet afariste me Bankën dhe anëtarët e Raiffeisen Banking Group si dhe me qëllim të krijimit të një baze të përbashkët të të dhënave për klientët, të informimit të tij për produktet e ofruara nga Banka dhe anëtarët e Raiffeisen Banking Group. Ky pëlqim do të përfshijë edhe prezentimin dhe transferin e të dhënave personale të Klientit palëve të treta. Palë të treta konsiderohen ata persona të cilët janë të nevojshëm për realizimin e veprimeve juridike të kontraktuara midis Klientit dhe Bankës apo cilitdo anëtarë të Raiffeisen Banking Groupit si dhe institucionet e tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Klienti konfirmon se të gjitha informacionet që ia ka dhënë bankës janë të vërteta dhe të sakta dhe është në dijeni se cdo deklaratë e falsifikuar, e pavërtetë apo mashtruese mund të ketë për pasojë ndjekjen penale dhe njëkohësisht Klienti pranon cdo shpenzim, humbje ose dëm që mund ti shkaktohet si pasojë e dhënies së informatave jo të vërteta, të pasakta ose mosinformimit me kohë të Bankës për ndrrimet e informacioneve personale, adresës, numrit të telefonit, email adresën etj.

Neni 7

Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje Klienti deklaron se e ka lexuar me vëmendje këtë Marrëveshje dhe vërteton se është i njoftuar se norma e interesit e cekur në Nenin 2 mund të ndryshoj në pajtim me vendimin e Bankës për norma të interesit.

Neni 8

Palët kontraktuese kanë rënë dakord se kjo Marrëveshje do të jetë objekt i ligjeve të zbatueshme në Kosovë. Çdo mosmarrëveshje midis palëve të përfshira në këtë Marrëveshje, e cila nuk mund të zgjidhet me marrëveshje të dyanshme, do të zgjidhet në gjykatat kompetente në Kosovë. Në çdo kohë dhe për çdo arsye, Banka ka të drejtë në mënyrë të njëanshme t'i transferoj të drejtat e tij sipas kësaj Marrëveshje palës së tretë e cila me këtë rast pranon përgjegjësitë e Bankës. Çdo transfer i të drejtave të Bankës, titulli dhe interesi në këtë Marrëveshje nuk kërkon aprovimin e Klientit, mirëpo Banka është e obliguar ta informoj Klientin sa i përket kësaj. Klienti nuk ka të drejtë t'i transferoj të drejtat dhe detyrimet e tij të përcaktuara në këtë Marrëveshje palës së tretë.

Kushtet e mësipërme të Marrëveshjes janë pranuar
nga klienti



Në pajtim me Rregullën për informimin e klientëve të anëtarëve të Fondit të Sigurimit të Depozitave të Kosovës, Depozituesi/Klienti jep:

DEKLARATË

Unë vërtetoj që kam marrë nga Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. shpjegimet verbale dhe fletëpalosjen për informimin e klientëve mbi sigurimin e depozitave në Kosovë.

Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C. St. Robert Doll no. 99 * Pristina, Kosovo
Tel.: + 383 (0)38 222 222 * www.raiffeisen-kosovo.com * Email:info@raiffeisen-kosovo.com
MEMBER OF THE AUSTRIAN RAIFFEISEN BANKING GROUP